



5 PRILL 2023

Në datën 5 prill 2023, dy anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Klodian Kurushi dhe z. Dritan Hallunaj pritën në një takim zyrtar pune një delegacion nga Britania e Madhe, i përbër nga përfaqësues nga Ministria e Jashtme, Shërbimi i Provës dhe Burgjeve, Departamenti për Punët e Brendshme, si dhe Atasheu për Punët e Brendshme dhe Çështjet e Drejtësisë pranë Ambasadës Britanike në Tiranë.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar, në fuqi që prej majit të vitit 2022.

Dy anëtarët e Këshillit nga rradhët e gjyqësorit, me përvojë profesionale të konsoliduar në fushën e së drejtës penale, Z. Kurushi, në cilësinë edhe të Kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Z. Hallunaj, Kryetar i Komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional (në kuadër të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve) trajtuan sfidat dhe mundësitë që lindin nga zbatimi praktik i kësaj marrëveshjeje.

Pjesëmarrësit në takim shkëmbyen eksperiencën dhe mendime mbi mekanizmat e mundshëm të cilat mund të sjellin një zbatim më të mirë të marrëveshjes së transferimit të personave të dënuar nga Britania e Madhe dhe Irlanda e Veriut në Shqipëri, sidomos nga perspektiva e reduktimit të afateve kohore të këtij procesi. Zhvillimi me ekspertizën britanike të një kurrikule të dedikuar për trajnimin e trupës gjyqësore në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, krijimi i një rrjeti të gjyqtarëve penalist me fokus në trajtimin e çështjeve të transferimit si dhe krijimi i një liste prioritare për këto lloje çështjesh ishin disa nga sugjerimet e diskutuara në takim.

Në mbyllje të diskutimit, palët u shprehën se mbeten të hapur për të vijuar me tej bashkëpunimin në kuadër jo vetëm të zbatimit praktik të marrëveshjes së transferimit por edhe forcimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Në datën 18.04.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e projektit MATRA “Open Court Through Press Judges” të implementuar nga INFOÇIP, zhvilloi tryezën e dytë të bashkëbisedimit mbi konsultimin e “Projektudhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”.

Në takim ishin të pranishëm znj. Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, z. Besnik Dervishi Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, znj. Edlira Osmani Eksperte e Nivelit të Lartë për Shtetin e së Drejtës nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, ekspertët e projektit EWMI, gjyqtarë të caktuar për mediat si dhe përfaqësues të mediave.

Gjatë këtij konsultimi publik, diskutimet u përqëndruan tek rekomandimet e përfaqësuesve të mediave, me qëllim baraspeshimin e misionit të medias për informimin me integritet e profesionalizëm dhe detyrimin të gjykatave për të ofruar transparencë dhe standarde ligjore që garantojnë të drejtat e njeriut dhe nuk censurojnë median.



12 MAJ 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në respektim të nenit 170 të Ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, zhvilluan mbledhjen e përbashkët vjetore në Korçë. Ky aktivitet u organizua me mbështetjen financiare të projektit “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri” (SEJ IV), i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli Evropës dhe i zbatuar nga ky i fundit.

Në këtë takim, krahas anëtarëve të dy këshillave morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet e vendit, si Zv. Ministria e Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme dhe misionet ndërkombëtare që asistojnë këshillat. Gjithashtu, i ftuar nderi në këtë mbledhje ishte edhe ish-Presidenti i Komisionit Evropian të Këshillit të Europës për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), njëkohësisht ekspert i lartë i CEPEJ, Mr. Georg Stawa.

Mbledhja u hap me fjalën e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla, i cili theksoi rëndësinë e mbajtjes së këtij takimi në qytetin e Korçës, si një nga qytetet që u prek më së shumti nga procesi i riorganizimit sipas “Hartës së Re Gjyqësore”.

Ndërsa Zv.Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi në fjalën e tij përshëndetëse nënvijëzoi se tashmë “Harta e Re Gjyqësore” është fakt dhe zbatimi i saj pritet të sjellë efekte dhe rezultate pozitive për sistemin gjyqësor.

Në këtë takim, ish-presidenti i CEPEJ Mr. Georg Stawa u shpreh i kënaqur nga rezultatet e arritura falë “Hartës së Re Gjyqësore” dhe theksoi rëndësinë që ka zbatimi i saj gjatë këtyre 5 viteve. Z. Stawa, gjatë prezantimit të tij i kushtoi vëmendje të veçantë mjeteve dhe praktikave më të mira të CEPEJ lidhur me menaxhimin e kohës gjyqësore si dhe trajtimin e stokut të çështjeve të prapambetura, duke nënvijëzuar rëndësinë e bashkëpunimit në kuadër të shkëmbimit të përvojave në këtë drejtim.

Në vijim të takimit, fjalën e morën përfaqësuesit e dy këshillave të cilët trajtuan çështje me interes të përbashkët. Znj. Brikena Ukperaj, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor u ndal tek sfidat e Këshillit për reduktimin e stokut të çështjeve të prapambetura duke identifikuar masat e marra në këtë drejtim si dhe impaktin e tyre në sistemin gjyqësor përmes analizimit të indikatorëve të efikasitetit.

Një tjetër temë me rëndësi të veçantë, e cila u elaborua nga znj. Marcela Shehu, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun ishte roli i këshillave në forcimin e marrëdhënieve me median dhe publikun. Znj. Shehu, hodhi dritë mbi arritjet e Këshillit në këtë drejtim duke projektuar gjithashtu edhe nevojat e vazhdueshme për përmirësime në të ardhmen të cilat janë të domosdoshme në epokën dixhitale që po jetojmë.

Takimi u përmbyll me diskutimet e dy këshillave mbi sfidat e përbashkëta si dhe gjetjes së mekanizmave të duhur për zgjidhjen e tyre.



Znj. Marçela Shehu, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, njëkohësisht Kryetare e Komisionit Disiplinor dhe anëtarja e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, mori pjesë në takimin prezantues të projektit: “Shoqëria civile kundër korrupsionit – nga një sfidë vendase në një përgjigje Europiane”.

Të ftuar të tjerë në këtë aktivitet, ishin përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave si dhe anëtarë të shoqërisë civile dhe medias.

Kjo nisëm, e mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian, do të zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra A.L.T.R.I) dhe organizatën Friends of Europe (FoE). Përmes kësaj iniciative 36 mujore synohet përfshirja proaktive, krijimi dhe forcimi i urave të bashkëpunimit me disa prej aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit.

Znj. Shehu në fjalën e saj, theksoi qasjen e hapur dhe bashkëpunuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor me organizatat e shoqërisë civile, si partner të panegociueshëm në funksion të forcimit dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës. Qasje kjo, e cila vjen e materializuar përmes bashkëpunimeve të hershme me organizatat zbatuese të këtij projekti.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim pune znj. Laura Liguori, drejtuese e projektit “EU4Justice”, i cili pritet të filloj së shpejti nga zbatimi.

Takimi u zhvillua me tone të ngrohta dhe miqësore dhe u fokusua kryesisht në vendosjen e urave të bashkëpunimit midis institucionit të KLGJ-së dhe projektit, i cili do të zbatohet për një periudhë kohore 24 mujore. Vëmendje të veçantë në diskutim, ju kushtua zbatimit të hartës së re gjyqësore, si projekti më madhor i Këshillit në drejtim të rritjes së efikasitetit dhe optimizimit të burimeve njerëzore në gjykata.

Pjesëmarrësit u dakordësuan për vijimin e bashkëpunimit midis tyre në të ardhmen e afërt në funksion të konsolidimit të institucioneve të qeverisjes së gjyqësorit.



Ambasadorja Yuri Kim u takua 31 Maj 2023 me Këshillin e Lartë Gjyqësor për t’i falënderuar për bashkëpunimin e tyre gjatë tre viteve e gjysmë të fundit dhe për t’i nxitur ata që të ngulmojnë. Ajo pohoi sërish mbështetjen e fortë të SHBA për KLGJ-në dhe institucionet e tjera të drejtësisë dhe u bëri thirrje anëtarëve të KLGJ-së që të përmbushin detyrën e tyre me integritet dhe pavarësi. Ajo i kërkoi KLGJ-së të plotësojë sa më shpejt tre vendet e mbetura në Gjykatën e Lartë me gjyqtarët më të kualifikuar. Ajo theksoi gjithashtu pritshmëritë e SHBA që KLGJ të zgjedhë gjyqtarë me integritet dhe aftësi profesionale për Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe gjykatat më të ulëta. “Është koha për t’u shkëputur nga mënyrat e vjetra. Reforma në drejtësi duhet të vazhdojë të zbatohet në mënyrë që Shqipëria të ecë përpara dhe zyrtarët duhet të veprojnë me integritet pavarësisht kërcënimeve dhe nxitjeve”, tha ambasadorja Kim në KLGJ.



2 QERSHOR 2023

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim kortezie Presidentin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), z. Christophe Straudo.

Gjatë takimit, z. Straudo, i cili mban njëkohësisht edhe detyrën e Drejtuesit të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, u shoqërua nga z. Artur Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vend.

Në takimin e zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami, vlerësoi mes të tjerash bashkëpunimin shumë korrekt me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. “Puna e z. Metani dhe e ekipit të tij ka qenë profesionale dhe ka reflektuar standarde shumë të mira në funksion të garantimit të përgjegjshmërisë, paanësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor” – tha Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke shtuar se “pikërisht kjo punë profesionale do të ndikojë në rritjen e performancës së gjyqtarëve dhe akoma më shumë në rritjen e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Ky takim u zhvillua në kuadër të vijimit të bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, ku bashkëbiseduesit diskutuan mbi sfidat e përbashkëta për të siguruar pavarësi, integritet dhe etik në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, sidomos në kontekstin e ri të zhvillimeve të teknologjisë së informacionit.



Me ftesë të Rrjetit Evropian të Këshillave për Gjyqësorin (ENCJ), Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme e cila u mbajt në datat 7 dhe 8 qershor, në Lubjanë, Slloveni.

Hapja e Asamblesë së Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësor u përshëndet nga Presidentja e Rrjetit znj. Dalia Vasariene, Presidenti i Këshillit Gjyqësor të Sllovenisë, z. Vladimir Horvat, si dhe Përfaqësuesja e Shoqatës Evropiane të Gjyqtarëve, znj. Janja Roblek.

Këtë vit, Rrjeti mirëpriti pranimin e Bosnje Hercegovinës, Ukrainës dhe Moldavisë si tre shtete të reja anëtare, në rolin e vëzhguesit të Rrjetit.

Lajtmotivi i Asamblesë së Përgjithshme këtë vit është “Courts fit for the future”, e cila konsiston në përgatitjen e gjykatave për t’iu përshtatur të ardhmes dhe promovimin e drejtësisë dixhitale.



12-13 QERSHOR 2023

Me ftesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnje-Hercegovinës, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, po merr pjesë në takimin rajonal që po zhvillohet në Sarajevë, në datat 12-13 qershor.

Fokusi i këtij takimi është “Bashkëpunimi rajonal mbi çështjet e teknologjisë së informacionit (TIK) në gjyqësor” si një përpjekje për të nxitur të gjitha vendet e rajonit të shkëmbejnë eksperiencën midis tyre në funksion të digjitalizimit të procedurave gjyqësore.

Ndërtimi i sistemeve të menaxhimit të çështjeve si dhe aplikimi i inteligjencës artificiale janë disa nga sfidat e përbashkëta mbi të cilat pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht, në prani edhe të ish presidentit të CEPEJ, z. Georg Stawa.

16 QERSHOR 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me mbështetjen e prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri, organizoi një takim rajonal në kuadër të zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat.

Në këtë takim ishin të pranishëm znj. Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, z. Cailean Maclean shef i Departamentit Ligjor dhe të Drejtave të Njeriut pranë OSBE, gjyqtarë të caktuar për mediat, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të mediave si dhe përfaqësues nga bota akademike.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth pritshmërive që ka media dhe shoqëria civile për marrëdhënien e ndërveprimit dhe të komunikimit me gjykatat.



26 QERSHOR 2023

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, mori pjesë në takimin rajonal mbi reformën në drejtësi, që u zhvillua në Vienë, Austri.

Ky takim u organizua me ftesë të Ministres së Drejtësisë së Austrisë, znj. Alma Zadić dhe fokusi i tij ishin zhvillimet në sektorin e drejtësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Pjesëmarrësit diskutuan mbi sfidat por edhe praktikatat më të mira në rajon lidhur me çështjet e digjitalizimit dhe eficientës në gjyqësor.



Kryetarja e KLGj-së, Znj. Naureda Llagami e shoqëruar nga zëvendëskryetari i Këshillit, z. Ilir Rusi, pritën në një vizitë zyrtare pune, një delegacion nga Këshilli Prokurorial i Kosovës i cili shoqërohej nga z. Alfred Balla, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë.

Takimi u zhvillua në tone të ngrohta dhe miqësore duke prekur si çështje të reformave në drejtësi në të dy vendet, arritjet dhe sfidat në këtë fushë ashtu dhe rolin, organizimin dhe funksionimin e institucioneve të pavarura të drejtësisë.

Çështje të cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë, hartës së re gjyqësore dhe procesit të rivlerësimit kalimtar ishin gjithashtu objekt diskutimi mes dy delegacioneve.

Në mbyllje të takimit palët u angazhuan për vazhdimin e bashkëpunimit dhe rritjen e shkëmbimit të eksperiencave midis institucioneve të drejtësisë të Kosovës dhe Shqipërisë dhe në të ardhmen.



MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

Këshilli vendosi të miratojë rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për:

- periudhën e vlerësimit **2020-2022, për 9 gjyqtarë** pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023;
- periudhën e vlerësimit **01.01.2019 – 07.02.2020, për 1 gjyqtare** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- periudhën e vlerësimit **01.01.2019 – 15.04.2021 për 1 gjyqtare** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- periudhën e vlerësimit **01.01.2019 – 01.06.2020, për 1 gjyqtar** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në vijim KLGJ miratoi vendimet për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për:

- periudhën e vlerësimit **viti kalendarik 2022, për 6 gjyqtarë;**
- periudhën e vlerësimit **viti kalendarik 2019, për 2 gjyqtarë;**

- periudhën e vlerësimit **10.02.2020 – 21.11.2022, për 1 gjyqtare** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në kuadër të procesit të vlerësimit etik profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 mujorit të dytë 2023 vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, **për 6 gjyqtarë** (2 për nga të cilët për periudhën gjatë ushtrimit të detyrës së inspektorit pranë Inspektoratit të Ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë) për periudhën 2013-2016. Gjithashtu Këshilli miratoi raportet për vlerësimin etik dhe profesional të **1 gjyqtare** për vitin 2021 dhe të **1 gjyqtar** për periudhën 2017-2019.

Këshilli vendosi t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatës **znj. Enkelejda Metaliaj**, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi të propozojë për emërim në Gjykatën e Lartë:

- në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, kandidaten znj. Vojsava Osmanaj;
- në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, kandidatin z. Valbon Çekrezi.

Pas verifikimit të plotësimit të kushteve të komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, Këshilli vendosi t'i dërgojë Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për t'u komanduar dhe konkretisht të z. Elton Frashëri, znj. Alda Sadiku, znj. Eva Hysku, znj. Sonila Hoxha dhe znj. Albana Misja.

Në kuadër të procesit të plotësimit të pozicioneve të lira në gjykata, Këshilli vendosi ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. Enerjeta Shehaj.

Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për:

- **4 (katër) pozicione të lira** në Gjykatën Administrative të Apelit;
- **9 (nëntë) pozicione të lira** në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Këshilli miratoi vendimet për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për:

- **6 (gjashtë) pozicione të lira** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, konkretisht 4 (katër) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 2 (dy) pozicione të lira në fushën e të drejtës penale;
- **2 (dy) pozicione të lira** në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konkretisht 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- **3 (tre) pozicione të lira** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Këshilli miratoi vendimet për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve të kandidimit, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, **për 19 kandidatë**.

Në vijim të këtyre procedurave, Këshilli vendosi për **kualifikimin e 2 kandidatëve** dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Këshilli miratoi vendimet për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, **për 13 kandidatë**.

Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin e **12 kandidatëve** dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin e 4 kandidatëve dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimet për transferimin e **4 gjyqtarëve** konkretisht znj. Diamela Goxha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; znj. Yrfet Shkreli në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan si dhe z. Gentian Marku e znj. Flutura Hoxha në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Këshilli, pas hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në përputhje me dispozitat ligjore vendosi përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit z. Hazbi Balliu pranë kësaj gjykate.

Këshilli ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit për **2 gjyqtarë**.

Në kuadër të përgjegjësive mbi rekrutimin e gjyqtarëve të rinj, Këshilli vendosi kualifikimin e **1 kandidati** për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022, profili gjyqtar.

Gjithashtu, KLGJ-ja ka vendosur kualifikimin e **2 kandidateve** fituese konkretisht 1 kandidate profili ndihmës ligjore në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023 dhe 1 kandidate profili këshilltare ligjore për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2021 – 2022.

DISIPLINA

Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe Këshilli ka vijuar me shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj disa magjistratëve duke konkluduar si më poshtë:



- Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj 2 magjistratëve, deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve respektive të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Shtyrjen e seancave dëgjimore për fillimin e procedimeve disiplinore në ngarkim të një magjistrati, në fuksion të garantimit të mbrojtjes efektive dhe procesit të drejtë ligjor si dhe fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit.
- Në vijim të shqyrtimit në seancë dëgjimore publike të kërkesave së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimeve disiplinore nr. 3/2022; nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, Këshilli vendosi pezullimin procedimeve disiplinore për një afat kohor 1 vjeçar.

HARTA E RE GJYQËSORE

Në kuadër të zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore”, për zbatimin e dytë të riorganizimit të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Këshilli miratoi vendimet për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Kavajë, Lushnjë, Përmet, Kurbin, Pogradec, Tropojë, Pukë dhe Krujë. Lidhur me këtë vijim janë miratuar vendimet për transferimin e kancelarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore që iu nënshtruan riorganizimit.

Gjykatat e shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm filluan funksionimin në 01.05.2023

Lidhur me fazën e tretë e cila konsistoi në riorganizimin e gjykatave administrative të shkallës së parë, Këshilli miratoi vendimit nr. 271-272 datë 25.05.2023 që konsistojnë në fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Këto akte normative nënligjore konsistojnë në miratimin e rregullave mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative të shkallës së parë. Lidhur me këtë funksion janë miratuar:

- Vendimi nr. 286, datë 29.05.2023, me anë të së cilës është vendosur numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 gjyqtarë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, 9 gjyqtarë;
- Vendimi nr. 298, datë 30.05.2023, me anë të së cilës është vendosur miratimi i rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Vendimi nr. 299, datë 30.05.2023, me anë të së cilës është vendosur miratimi i rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;

- Vendimi nr. 300, datë 30.05.2023, me anë të së cilës është vendosur caktimi i numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Vendimi nr. 301, datë 30.05.2023, me anë të së cilës është vendosur caktimi i numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë;
- Vendimi nr. 303, datë 05.06.2023, me anë të së cilës është vendosur krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Korçë dhe Shkodër;
- Vendimi nr. 304, datë 05.06.2023, me anë të së cilës është vendosur krijimi e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe Vlorë;
- Vendimet nr. 337-340, datë 27.06.2023, me anë të së cilave është vendosur transferimi i kancelarëve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë; Vlorë; Durrës dhe Korçë.

TRANSPARENCA




Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor **trajtoi 18 kërkesa për caktimin e 24 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve** gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **7 kërkesa për informacion**, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **119 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KLJGJ-së (Prill-Qershor 2023):



- 22 mbledhje plenare
- 190 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 16 akte kolektive, Prill 2023
 - 37 akte kolektive, Maj 2023
 - 10 akte kolektive, Qershor 2023
 - 46 akte individuale, Prill 2023
 - 37 akte individuale, Maj 2023
 - 33 akte individuale, Qershor 2023

Pjesa tjetër përfshihen 6 akte normative nënligjore dhe 5 rregulla të brendshme.



KLJGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

2429

-na ndiqni-

Adresa: Godina "Poli i Drëjtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë

www.klgj.al

e-mail: kontakt@klgj.al